



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO*

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**

---

Numri i lëndës: 2022:224782  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05488808

CP.nr.793/2013

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, T.R., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Y.K., nga Prizreni, kundër debitorit, A.M., nga Prizreni, Rr..... nr..... në Prizren, e të cilën e përfaqëson, bashkëshortja e tij dhe përfaqësuesja e përkohshme, B.M., nga Prizreni e të cilën me autorizim e përfaqëson av. N.K., nga Prizreni, për shkak të përmbartimit të dokumentit të përmbartimit – aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.972/09 të dt.12.04.2011 për shkak të kompensimit të dëmit në shumën prej 3.418.43 eurove si dhe shpenzimeve të gjykuara të procedurës kontestimore në shumën prej 3.253.20 eurove e në totalin e tij prej 6.671,63 eurove, i lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.793/13 të dt.03.06.21013, dhe me plotësimin e propozimit për përmbartim, të lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.793/2013 të dt.02.08.2016, jashtë seancës me datën 22.03.2024, mori këtë :

**A K T V E N D I M**

I.PËRFUNDON procedura e përmbartimit në çështjen juridike të përmbartimit, CP.nr.793/2013, për shkak të përmbushjes së kredisë së kreditorit.

II. Aktvendimi CP.nr.793/2013 i datës 31.10.2016, lidhur me transferin e mjeteve, vazhdon të mbetet në fuqi, deri në përmbushjen definitive.

**A r s y e t i m**

Kreditori i përmbartimit, T.R., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson, Y.K., nga Prizreni, kundër debitorit të përmbartimit, A.M., nga Prizreni, Rr.....” nr..... në Prizren, e të cilën e përfaqëson, bashkëshortja e tij dhe përfaqësuesja e përkohshme, B.M., nga Prizreni, e cila me autorizim përfaqësohet nga av. N.K., nga Prizreni, ka paraqitur propozim për përmbartim, për shkak të përmbartimit të dokumentit të përmbartimit – aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.972/09 të dt.12.04.2011 për shkak të kompensimit të dëmit në shumën prej 3.418.43 eurove si dhe shpenzimeve të gjykuara të procedurës kontestimore në shumën prej 3.253.20 eurove e në totalin e tij prej 6.671,63 eurove dhe i lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate, E.nr.793/13 të dt.03.06.21013, dhe me plotësimin e propozimit për përmbartim, të lejuar me aktvendimin CP.nr.793/2013 të dt.02.08.2016.

Numri i lëndës: 2022:224782  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05488808

Gjykata duke proceduar më tej në këtë çështje juridike të përmbarimit, ka ndërmarr disa veprime të përmbarimit, e pas propozimit të palës kreditore që të bëhet plotësimi i propozimit të saj përmbarim edhe me mjetet tjera të përmbarimit – bllokimin e xhironlogarive bankare të debitores së përmbarimit, me aktvendimin e saj, E.nr.793/2013 të dt.2.8.2016, ka lejuar plotësimin e propozimit për përmbarim edhe me këtë mjet të përmbarimit.

Kjo gjykatë me aktvendimin CP.nr.793/2013 të datës 31.10.2016, e ka urdhëruar ..... Bank me seli në Prishtinë, që të bëjë debitimin e mjeteve në shumën prej 6,671.63 euro, nga llogaria bankare e debitorit, të i bartë transferoj të kreditori në llogarinë e tij.

..... Bankë me seli në Prishtinë, me datën 05.07.2023 e ka njoftuar këtë gjykatë se, Aktvendimi Cp.nr.793/2013 është duke u ekzekutuar në mënyrë periodike, për çdo muaj transferohen 73.00 euro, dhe totali deri me sot me datën 05.07.2023 janë transferuar mjetet në shumën prej 4,428.00 euro, nga llogaria e debitores, B.M., në llogarin e kreditorit, av. D.V..

Gjykata ka caktuar seancën e datës 21.03.2024, ku i autorizuari i kreditorit, ka deklaruar se, pasi që është transferuar shuma, sipas informatës së ..... Bank dhe atë shuma prej 4,428.00 euro është transferuar në llogari të kreditorit, dhe është duke vazhduar të transferohet pagesa, i propozoj gjykatës që kjo lëndë të mbyllet dhe aktvendimi për transfer i drejtuar bankës të mbetet në fuqi deri në përfundimin e pagesës.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe propozimit të autorizuari të kreditorit, vlerësoj se, pas përmbushjes së kredisë së kreditorit, janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedura e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit, dhe atë për këto arsye :

Kështu në këtë situatë juridike, pra për institutin juridik të përmbushjes së kredisë së kreditorit, në këtë çështje juridike të përmbarimit, parashihet në nenin 66 par.4 të LPP-së, e në të cilin, thuhet se: *''Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore''*. Në këtë rast i autorizuari i kreditorit në seancën e datës 21.03.2024 ka propozuar që kjo çështje përmbarimore të mbyllet dhe aktvendimi për transfer drejtuar bankës të mbetet në fuqi deri ne përfundimin e pagesës së mbetur, andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë e përfundoj përmbarimin në çështjen juridike të përmbarimit, CP.nr.793/2013, pasi që është përmbushur kredia e kreditores, ndërsa Aktvendimin CP.nr.793/2013 të datës 31.10.2016, lidhur me transferin e mjeteve për shumën e mbetur, vazhdon të mbetet në fuqi, deri në përmbushjen definitive.

Prandaj nga të thënat si me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenin 3, dhe nenin 66 par.4 të LPP-së.

## GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.793/2013

Datë 22.03.2024

Gjyqtari  
Sami Gashi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të aktvendimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.